

PËR PRINDËRIT

Nëse ka dyshime për komunikim dhe vështirësi me ndërveprimin social



Fëmija juaj u vizitoi te qendra shëndetësore për fëmijët. Gjatë kësaj vizite, fëmija u ekzaminua lidhur me zhvillimin e komunikimit dhe aftësitë e tij të ndërveprimit social. Ne konstatuam se fëmija juaj ka vështirësi në komunikim, por edhe me atë që ne e quajmë ndërveprim social.

Ndërveprimi social

Shembuj të vështirësive të ndërveprimit social mund të jenë se fëmija juaj nuk ka shumë kontakt me sy; nuk reagon kur e thërrasin me emër; nuk e ndjek prindin kur ai i tregon diçka; nuk tregon me gisht kur do diçka dhe/ose nuk luan, duke bërë pretenduar/ duke imagjinuar (për shembull, sikur është në supermarket ose me kukulla).

Rekomandim për vazhdimësinë e vlerësimeve

Si pjesë e rutinës së qendrave shëndetësore për fëmijët rekomandohet që të vijohet me vlerësime të vazhdueshme kur një fëmijë konsiderohet se ka vështirësi në komunikim dhe ndërveprim shoqëror. Në disa raste, vlerësimi i vazhdueshëm kryhet nga shërbimet shëndetësore për prindërit e fëmijët dhe në raste të tjera rekomandimi dërgohet te shërbimet e rehabilitimit për fëmijët dhe të rinjtë. Më pas, caktohet një vizitë dhe në varësi të njësisë se ku është dërguar rekomandimi, atje do të jenë të pranishëm pjesëtarë të ndryshëm të stafit.

Autizmi

Ajo që stafi do të bëjë gjatë vizitës është të shikojë nëse fëmija juaj mund të ketë vështirësi brenda asaj që njihet si spektër i autizmit. Autizmi nuk është një sëmundje, por kjo do të thotë se truri funksionon në një mënyrë tjetër. Autizmi ndikon në mënyrën e të menduarit, të të qenit dhe komunikimit të një personi me të tjerët. Ai karakterizohet nga fakti se fëmija është zakonisht më i ngadalshëm në zhvillimin e tij të komunikimit dhe se ai nuk ndërvepron dhe luan në të njëjtën mënyrë si fëmijët e tjerë të së

njëjtës moshë.

Nëse dyshoni se fëmija është me autizëm, atëherë stafi do të sugjerojë që të bëhet një hetim. Arsyeja pse duam të konstatojmë autizmin te fëmijët në kohë është se ne e dimë se është e dobishme që fëmijët të ndihmohen në fazë të hershme lidhur me komunikimin dhe ndërveprimin e tyre me fëmijët e tjerë të së njëjtës moshë. Të gjitha përpjekjet ofrohen vullnetarisht dhe në çdo kohë mund të vendosni që nuk dëshironi të vazhdoni më me hetimin.

Vizitë për vlerësime të vazhdueshme

Në vizitën pranë shërbimeve shëndetësore për prindërit dhe fëmijët ose pranë shërbimeve për rehabilitimin e fëmijëve dhe të të rinjve, stafi do t'ju kërkojë të vini me fëmijën tuaj për të bërë një vlerësim fillestar.

Pyetjet rreth autizmit?

Për më shumë informacion mbi diagnozën e autizmit, ne rekomandojmë të vizitoni "Ndërhyrje e hershme" në faqen e internetit të Region Uppsala. Informacione të dobishme do të gjeni edhe në faqen www.1177.se (shkruani autizmi në hapësirën e kërkimit).

Nëse keni ndonjë pyetje pas vizitës te BVC-ja, mos hezitoni të kontaktoni me infermieren tuaj të BVC-së.